



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PERMET**

**P/VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ DATE \_\_\_\_\_

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 113 DATË 17.12.2025 "PËR MIRATIMIN E  
BUXHETIT TË BASHKISË VITI 2026 DHE PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË  
PUNONJËSVE TË BASHKISË INSTITUCIONEVE DHE NJËSIVE  
ADMINISTRATIVE NE VARËSI TË SAJ",I NDRYSHUAR**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Per menaxhimin fncanciar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore",i ndryshuar, Ligjit nr.43/2016 "Per marrëveshjet nderkombetare në Republikën e Shqipërisë",VKM nr.775 datë 24.09.2010"Per administrimin e financimeve te huaja",Udhëzim nr.10 datë12.07.2024" P e r rregjistrimin,përdorimin,rakordimin,raportimin dhe publikimin e fondeve te financimeve të huaja në kuadrin e marreveshjes nderkombëtare", Ligji nr.87/2025 datë 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë viti 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë ,institucioneve dhe njësive administrative në varësi të saj",i ndryshuar,Shkresës nr. 18273 datë 29.12.2025 "Dërgohet transferata e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026 " protokolluar me tonën nr.4348 datë 30.12.2025, të ndryshuar,me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ,

**VENDOSI:**

1.1 Të pakësohen shpenzimet në strukturën e mëposhtme:

në lekë

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	602	Përshkrimi
01110	AA135	V111AAD	01	120000	Mirëmbajtje pajisje



shtohen shpenzimet në strukturën e mëposhtme:

në lekë

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	231	Përshkrimi
01110	AA135	P111AAG	01	120000	Blerje pajisje elektronike (kondicionere)

2.1 Të pakësohen shpenzimet në strukturën e mëposhtme:

në lekë

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	231	Përshkrimi
08130	AD135	P813AAR	01	9913000	Bashkefinancimin e Stadiumit në bashkepunim me FSHF

2.2 Të shtohen shpenzimet në strukturën e mëposhtme:

në lekë

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	604	Përshkrimi
08130	AD135	P813AAR	01	9913000	Transfertë për Bashkefinancimin e Stadiumit në bashkepunim me FSHF

3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet Financës dhe Drejtoritë e tjera.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**  
**Alma HOXHA**



Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254, e-mail: info@bashkiapermet.gov.al / eëë.bashkiapermet.gov.al



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PERMET**

**RELACION**

**PËR**

**P/VENDIM**

**Nr. \_\_\_ DATE \_\_\_\_\_**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 113 DATË 17.12.2025 "PËR MIRATIMIN E  
BUXHETIT TË BASHKISË VITI 2026 DHE PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË  
PUNONJËSVE TË BASHKISË INSTITUCIONEVE DHE NJËSIVE  
ADMINISTRATIVE NE VARËSI TË SAJ",I NDRYSHUAR**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore",i ndryshuar, Ligjit nr.43/2016 "Per marrëveshjet nderkombetare në Republikën e Shqipërisë",VKM nr.775 datë 24.09.2010"Per administrimin e financimeve te huaja",Udhëzim nr.10 datë12.07.2024" P e r rregjistrimin,përdorimin,rakordimin,raportimin dhe publikimin e fondeve te financimeve të huaja në kuadrin e marreveshjes nderkombëtare", Ligji nr.87/2025 datë 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë viti 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë ,institucioneve dhe njësive administrative në varësi të saj",i ndryshuar,Shkresës nr. 18273 datë 29.12.2025 "Dërgohet transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026 " protokolluar me tonën nr.4348 datë 30.12.2025, të ndryshuar,me propozim të Kryetarit të Bashkisë, paraqesim për miratim pranë jush ndryshimet e mëposhtme buxhetore:

**1.Në buxhetin fillestar kishim parashikuar mirëmbajtjen e sistemit ftohës (Chiller) por për arsye të mosrealizimit të këtij zëri kërkojmë miratimin e ndryshimit të mëposhtëm:**

Të pakësohen shpenzimet në strukturën e mëposhtme:



në lekë

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	602(shpenzime)	Përshkrimi
01110(Aparati)	AA135	V111AAD	01	120000	Mirëmbajtje pajisje

Të shtohen shpenzimet në strukturën e mëposhtme:

në lekë

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	231( Investime)	Përshkrimi
011109(Aparati)	AA135	P111AAG	01	120000	Blerje pajisje elektronike( kondicionere)

2.Për shkak të një ndryshimi në draft marrëveshjen me FSHF-në nevojitet ndryshimi i mëposhtëm buxhetor:

Të pakësohen shpenzimet në strukturën e mëposhtme:

në lekë

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	231(Investim)	Përshkrimi
08130( Sporti)	AD135	P813AAR	01	9913000	Bashkefinancimin e Stadiumit në bashkëpunim me FSHF

Të shtohen shpenzimet në strukturën e mëposhtme:

në lekë

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	604(transferta)	Përshkrimi
08130(Sporti)	AD135	P813AAR	01	9913000	Transfertë për Bashkefinancimin e Stadiumit në bashkëpunim me FSHF

Ju faleminderit !

**KRYETAR I BASHKISË**

**Alma HOXHA**

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254/e-mail:info@bashkiapermet.gov.al / bashkiapermet.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET



PROJEKT- VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_ 2026

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRËNDSHME ,PËR ZBATIMIN E LIGJIT 86/2025,DATË 11.12.2025”PËR FSHIRJEN /SHUARJEN DHE PAGESËN E DETYRIMEVE TATIMORE NDAJ ADMINISTRATËS TATIMORE QËNDRORE DHE VENDORE DHE DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË”DHE UDHËZIMIT NR.11,DATË 14.05.2026”PËR ZBATIMIN E LIGJIT 86/2025”,TË MINISTRISË SË FINANCAVE.

Mbështetur në nenet 54 dhe 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Ligjin nr.10296,datë 08.07.2010, «Për menaxhimin financiar dhe kontrollin»,Ligji Nr. 86/2025”Për fshirjen /shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore dhe vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë”,Udhëzimi Nr. 11 datë 14.05.2026,” Për zbatimin e ligjit 86/2025”,të Ministrisë së Financave.

VENDOSI

1. Miratimin e rregullores së Brëndshme ,për zbatimin e ligjit 86/2025,datë 11.12.2025”Për fshirjen /shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore dhe vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë”dhe Udhëzimit nr.11,datë 14.05.2026”Për zbatimin e ligjit 86/2025”,të Ministrisë së Financave.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë Përmet dhe strukturat përkatëse të administratës së Bashkisë.
3. Efektet e veprimit të tij shtrihen nga data 14.05.2026 deri më 31.12.2026.
4. Ky vendim,hyn në fuqi pas miratimit në prefekturë.

KRYETARI I BASHKISË

Alma HOXHA



Sheshi "AbdylFrashëri" ;tel.+35581322254 e-mail info@bashkiapermet.gov.al www.bashkiapermet.gov.al



## RELACION

**Mbi Rregullorën e Brëndshme për zbatimin e ligjit 86/2025, datë 11.12.2025”Për fshirjen /shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qëndrore dhe vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë” dhe Udhëzimit nr.11, datë 14.05.2026”Për zbatimin e ligjit 86/2025”, të Ministrisë së Financave.**

Kjo rregullore bazohet në:

- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar
- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”
- Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, «Për menaxhimin financiar dhe kontrollin»,
- Ligji Nr. 86/2025”Për fshirjen /shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qëndrore dhe vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë”.
- Udhëzimi Nr. 11 datë 14.05.2026,” Për zbatimin e ligjit 86/2025”, të Ministrisë së Financave.

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e saktë dhe të qartë të rregullave për zbatimin e ligjit nr.86/2025, datë 11.12.2025, “Për fshirjen /shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qëndrore dhe vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë” dhe Udhëzimit nr.11, datë 14.05.2026”Për zbatimin e ligjit 86/2025”, të Ministrisë së Financave, ashtu sic dhe citohet në pikën 7 të kreut XIII, të Udhëzimit nr.11, datë 14.05.2026, i Ministrisë së Financave.

Në të është e përcaktuar:

- 1- Procedura për zbatimin e ligjit 86/2025
- 2- Tatim pagues/subjektet përfitues
- 3- Tatimpaguesit /subjektet që nuk përfitojnë
- 4- Fshirja e detyrimeve tatimore.
- 5- Shuarja pjesore e detyrimeve tatimore, me kusht pagimin e tatimit/taksës/tarifës
- 6- Afati i zbatimit dhe e drejta e ankimimit
- 7- Drejtoritë zbatuese dhe afati për fshirjen e detyrimeve tatimore

Duke parë me vëmendje ligjin 86/2025 dhe udhëzimin në zbatim të këtij ligji dhe duke u bazuar dhe në punën e përditëshme të Sektorit të Tatim Taksave e pamë të arsyeshme që për t’i trajtuar dhe taksapaguesit/subjektet në mënyrë të barabartë ,gjë të cilën dhe ligji dhe udhëzimi na e jep të drejtën për miratimin e rregullave sipas rasteve që janë në fushën e përgjegjësisë sonë, të hartonim këtë rregullore me rregulla më të qarta.

Rregullorja në parim ka gjithë zbërthimin e bazës ligjore për tu zbatuar ,por ajo që ndryshon në gjithë hapësirën e ligjit është:



- Të gjitha detyrimet që përfshihen në pikën 5 të nenit 5, të ligjit ,detyrimet tatimore të papaguara të vendosura për subjektet e crregjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit shuhen.

Për subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet edhe pse figurojnë të crregjistruara në QKB ,por në të njëjtën kohë që nga periudha e crregjistrimit është aktiv deri më sot,e vërtetuar kjo nga punonjësit tanë edhe në këtë moment me akt verifikime ,konform ligjit për taksat vendore,mendojmë se këtyre subjekteve nuk duhet t'u fshihen detyrimet vendore për asye se është përfitues i shërbimeve vendore.

Sot në territorin e Bashkisë kemi 9 subjekte të tilla të cilat në total kanë rreth 528,078 lekë detyrime të prapambetura dhe jo vetëm kaq,por sot po bëhet trend crregjistrimi nga QKB,për t ju fshehur pagesave nga detyrimet vendore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

### KOMISIONI

1.Florand HASANI Nën/Kryetari që përgjigjet për ekonominë dhe financat vendore - Kryetar

2.Etleva KRECI Drejtor i Buxhet Financaës,Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse – Anëtar 

3.Etleva MYFTARI Drejtor i Zhvillimit Ekonomik,Bujqësi,Turizmit – Anëtar 

4.Dorjan METKO Përgjegjësi i Sektorit të Tatim Taksave,Aseteve dhe Licencave- Anëtar 

5.Vangjela NAQE Përgjegjësi i Sektorit të Financës – Anëtar 

6.Paskal LONDO Përgjegjësi i Sektorit të Urbanistikës- Anëtar 

7.Ketrina LILE Jurist 





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_ 2026

PËR

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 125, DATË 17.12.2025 TË KËSHILLIT BASHKIAK PËRMET "PËR MIRATIMIN E NMARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË PËRMET DHE FSHF-SË, MIRATIMIN E FINANCIMIT TË FSHF-SË PËR RIKONSTRUKSIONIN E PJESHËM TË STADIUMIT DURIM QYPI, "PËRMET", SI DHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË KRYETARIT TË BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E SAJ".

Këshilli Bashkiak Përmet, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", të ndryshuar, E-mail të dërguar nga FSHF datë 29.5.2026 "Për ndryshime në draft marrëveshje" si dhe në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Bashkisë Përmet dhe Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), me qëllim garantimin e realizimit në kohë të projektit dhe përbushjen e detyrimeve financiare të marra përsipër nga Bashkia Përmet,

VENDOSI:

1. Kontributi financiar i Bashkisë Përmet për vitin 2026, në vlerën 9,913,000 (nëntë milionë e nëntëqind e trembëdhjetë mijë) lekë, do të disbursohet në favor të Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) menjëherë pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të kontratës.
2. Të gjitha dispozitat e tjera të Vendimit nr. 125, datë 17.12.2025, të Këshillit Bashkiak Përmet, të cilat nuk preken nga ky ndryshim, mbeten në fuqi.
3. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë Përmet, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Të Territorit, Sektorit Juridik Dhe Prokurimeve, Drejtorisë Së Financës, Burimeve Njerëzore Dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria E Zhvillimit Ekonomik Bujqesi Turizëm.
4. Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI I BASHKISË  
Alma HOXHA



Sheshi "AbdylFrashëri" ;tel.+35581322254 e-mail info@bashkiapermet.gov.al www.bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

DREJTORIA E URBANISTIKËS, PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, SEKTORIT JURIDIK DHE PROKURIMEVE

RELACION

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 125, DATË 17.12.2025 TË KËSHILLIT BASHKIAK PËRMET "PËR MIRATIMIN E NMARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË PËRMET DHE FSHF-SË, MIRATIMIN E FINANCIMIT TË FSHF-SË PËR RIKONSTRUKSIONIN E PJESHËM TË STADIUMIT DURIM QYPI, "PËRMET", SI DHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË KRYETARIT TË BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E SAJ".**

Përmet, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Bashkisë Përmet dhe Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 125, datë 17.12.2025, paraqitet ky relacion për miratimin e rishikimit të marrëveshjes, konkretisht të Nenit 4, pika 4(a).

Sipas marrëveshjes së miratuar, kontributi financiar i Bashkisë Përmet parashikohet të realizohet në dy këste, përkatësisht gjatë viteve 2026 dhe 2027, në përputhje me vlerat dhe ndarjen buxhetore të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Vlerat financiare të bashkëfinancimit dhe raporti i ndarjes ndërmjet palëve mbeten të pandryshuara. Ne piken, 4 shkronja "a" të vendimit nr.125 datë 17.12.2025 të Bashkiak Përmet, paragrafi :

*"Kontributi i Bashkisë Përmet për vitin 2026 do të jetë 9,913,000 (nëntë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë) lekë dhe do të justifikohet me situacionin e punimeve të realizuara",*

Shfuqizohet dhe zëvendësohet me këtë përmbajtje:

*"Kontributi i Bashkisë Përmet për vitin 2026 në vlerën 9,913,000 (nëntë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë) lekë do të disbursohet në favor të Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) menjëherë pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të kontratës".*

Rishikimi i propozuar i marrëveshjes synon vetëm përcaktimin e momentit të transferimit të kështit të parë të parashikuar për vitin 2026 ku propozohet që kështi i parë i vitit 2026 të transferohet në llogarinë e FSHF-së menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes.



Rishikimi i Nenit 4, pika 4(a) nuk sjell asnjë ndryshim në vlerën totale të kontributit të Bashkisë Përmet dhe nuk ndryshon ndarjen e financimit ndërmjet viteve 2026 dhe 2027;

Miratimi i rishikimit të marrëveshjes, konkretisht i Nenit 4, pika 4(a), është i domosdoshëm për garantimin e zbatimit të projektit sipas kushteve kontraktuale.

FALEMINDERIT!

Konceptoi: K.Lile

Miratoi: L.Bushi

  
  
1-16





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KRYETARI

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_ dt. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

**PËR EMERTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË PËRMET.**

me emrin: **BABA HEKURAN NIKOLLARI** (pas vdekjes)

Në mbështetje të Nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b" nënpika 1.7 shkronja "b" neni 54 shkronja II" dhe nenit 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, , veçanërisht dispozitat që përcaktojnë kompetencat e këshillit bashkiak për administrimin e çështjeve me interes vendor dhe emërtimin e hapësirave publike; neni 3 të ligjit 9270 datë 29.07.2004 "Për systemin e adresave" të ndryshuar, kërkesa e Komunitetit Bektashi në Përmet përfaqësuar nga Sekretari i Teqeve, z.Fatjon Skënderi, mbi bazën e relacionit të paraqitur si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Përmet

**V E N D O S I**

1. Miratimin e emërimit me emrin **BABA HEKURAN NIKOLLARI** (pas vdekjes) të segmentit rrugor në qytetin e Përmetit, me gjatësi 220 ml, Sipas fragmentit të hartës së paraqitur bashkëlidhur këtij Vendimi si më poshtë: *Segmenti nga kryqëzimi i ish degës ushtarake deri tek ish stacioni i vjetër i zjarrfikses.Me kordinata sipas KRGJSH, pika e fillimit: E 530347.34 N 4455255.34, pika e mbarimit E 530174.72 N 4455099.00.*
2. Çdo Vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Ekonomise Zhvillimit Buqësisë e Turizmit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55 pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar

KRYETARI I BASHKISË  
Alma HOXHA

*Alma HOXHA*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

RELACION

PËR EMERTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË PËRMET.

**Lënda:** Propozim për emërtimin e një rruge në nderim të Baba Hekuran Nikollarit (pas vdekjes)

Propozohet që rruga “Segmenti nga kryqëzimi i ish degës ushtarake deri tek ish stacioni i vjetër i zjarrfikses. Me kordinata sipas KRGJSH, pika e fillimit: E 530347.34 N 4455255.34, pika e mbarimit E 530174.72 N 4455099.00”, në territorin e qytetit Përmet të emërtohet me emrin “**Baba Hekuran Nikollari**”, në shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje për kontributin e tij të shquar fetar, shpirtëror, kulturor dhe shoqëror.

**HYRJE**

Nisur nga kërkesa e Komunitetit Bektashi në Përmet përfaqësuar nga Sekretari i Teqeve, z.Fatjon Skënderi, në kuadër të ruajtjes dhe promovimit të vlerave historike, kulturore, shpirtërore dhe identitare të Bashkisë Përmet, si dhe në funksion të përmirësimit të sistemit të adresave dhe identifikimit të hapësirave publike, paraqitet për shqyrtim dhe miratim propozimi për emërtimin e rrugës “Segmenti nga kryqëzimi i ish degës ushtarake deri tek ish stacioni i vjetër i zjarrfikses me emrin “**Baba Hekuran Nikollari**”.

Ky propozim synon nderimin e figurës së shquar të klerikut bektashian Baba Hekuran Nikollari, i cili me veprimtarinë e tij shumëvjeçare ka dhënë një kontribut të çmuar në jetën fetare, shoqërore dhe kulturore të krahinës së Përmetit dhe më gjerë.

**I. Baza Ligjore**

Ky propozim mbështetet në:

- Nenin 8 pika 2, nenin 9 pika1, nënpika 1.1 shkronja “b” nënpika 1.7 shkronja “b” neni 54 shkronja ll” dhe nenit 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, , veçanërisht dispozitat që përcaktojnë kompetencat e këshillit bashkiak për administrimin e çështjeve me interes vendor dhe emërtimin e hapësirave publike;
- Legjislacionin në fuqi për sistemin e adresave dhe administrimin e territorit; neni 3 të ligjit 9270 datë 29.07.2004 “Për systemin e adresave” të ndryshuar
- Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak Përmet;
- Nevojën për ruajtjen dhe promovimin e vlerave historike, kulturore dhe shpirtërore të territorit të Bashkisë Përmet.

Në mbështetje të këtyre dispozitave, Këshilli Bashkiak ka të drejtën të vendosë emërtimin e rrugëve dhe hapësirave publike brenda territorit administrativ të Bashkisë Përmet.

**II. Qëllimi i Propozimit**

Sheshi “Abdyl Frashëri”; tel.+35581322254; web:www.bashkiapermet.gov.al; e-mail:info@bashkiapermet.gov.al

- Qëllimi i këtij propozimi është emërtimi i rrugës “Segmenti nga kryqëzimi i ish degës ushtarake deri tek ish stacioni i vjetër i zjarrfikses”, me emrin “**Baba Hekuran Nikollari**”, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për kontributin e tij të veçantë në jetën fetare, kulturore dhe shoqërore të krahinës së Përmetit.

### III. TË DHËNA MBI FIGURËN E BABA HEKURAN NIKOLLARIT

Baba Hekuran Nikollari ishte një ndër personalitetet më të respektuara të komunitetit bektashian shqiptar dhe një figurë e njohur e jetës shpirtërore të krahinës së Përmetit.

Veprimtaria e tij lidhet ngushtë me Teqenë e Baba Aliut në Alipostivan, e kthyer tashmë në një nga qendrat më të rëndësishme të bektashizmit në Shqipëri. Përmes përkushtimit, urtësisë dhe shërbimit të tij ndaj komunitetit, ai kontribuoi në ruajtjen e traditave bektashiane dhe në forcimin e vlerave të harmonisë, tolerancës dhe bashkëjetesës ndërfaqetare.

Në periudhën e pas viteve 1990, kur institucionet fetare rifilluan aktivitetin e tyre pas dekadash ndalimi, Baba Hekuran Nikollari luajti një rol të rëndësishëm në ringritjen e jetës shpirtërore dhe në rikthimin e Teqesë së Alipostivanit në një qendër të rëndësishme pelegrinazhi dhe besimi.

Gjatë gjithë jetës së tij, ai u dallua për thjeshtësinë, humanizmin, urtësinë dhe gatishmërinë për t'u gjendur pranë njerëzve në nevojë. Figura e tij fitoi respekt të gjerë jo vetëm ndër besimtarët bektashinj, por edhe në të gjithë komunitetin përmetar dhe më gjerë.

### IV. ARSYETIMI I PROPOZIMIT

Emërtimi i rrugës me emrin “Baba Hekuran Nikollari” mbështetet në disa arsye themelore:

#### 1. Vlerësimi i kontributit shpirtëror dhe fetar

**Baba Hekuran Nikollari** i kushtoi jetën shërbimit fetar dhe edukimit shpirtëror të besimtarëve, duke kontribuar në ruajtjen e traditës bektashiane dhe në forcimin e vlerave universale të paqes, dashurisë dhe respektit reciprok.

#### 2. Kontributi në jetën shoqërore dhe komunitare

Veprimtaria e tij nuk u kufizua vetëm në aspektin fetar. Ai luajti një rol të rëndësishëm në forcimin e lidhjeve sociale, në promovimin e dialogut dhe në krijimin e një klime harmonie ndërmjet qytetarëve.

#### 3. Ruajtja e kujtesës historike lokale

Bashkia Përmet ka detyrimin institucional të ruajë dhe promovojë figurat që kanë lënë gjurmë të rëndësishme në historinë dhe identitetin e saj kulturor. Emërtimi i një rruge me emrin e Baba Hekuran Nikollarit do të shërbejë si një formë e qëndrueshme kujtese për brezat e ardhshëm.

#### 4. Promovimi i vlerave të tolerancës fetare

Figura e **Baba Hekuran Nikollarit** përfaqëson modelin e bashkëjetesës dhe respektit ndërfetar, vlera të cilat përbëjnë një pasuri të rëndësishme të shoqërisë shqiptare dhe të komunitetit përmetar.

#### 5. Kërkesë me interes publik

Emërtimi i propozuar gëzon interes publik pasi lidhet me një figurë të njohur dhe të respektuar nga komuniteti lokal, duke mos krijuar mbivendosje apo konfuzion me emërtime të tjera ekzistuese në territorin e bashkisë.

## V. Përfundime

Duke marrë në konsideratë:

- kontributin e veçantë të Baba Hekuran Nikollarit në jetën shpirtërore, kulturore dhe shoqërore;
- respektin dhe vlerësimin që ai gëzon në komunitetin përmetar;
- rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë historike dhe identitare të Bashkisë Përmet;

vlerësohet se ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore, historike dhe morale për emërtimin e rrugës së propozuar me emrin: **"BABA HEKURAN NIKOLLARI"** (pas vdekjes)

## VI. Konkluzioni

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak Përmet të miratojë emërtimin e rrugës *"Segmenti nga kryqëzimi i ish degës ushtarake deri tek ish stacioni i vjetër i zjarrfikses"* në qytetin Përmet me emrin:

**"RRUGA BABA HEKURAN NIKOLLARI"** (pas vdekjes)

si shenjë nderimi dhe mirënjohjeje për kontributin e tij të çmuar në jetën shpirtërore, kulturore dhe shoqërore të krahinës së Përmetit dhe të Shqipërisë.

## Bashkëlidhur:

1. Kërkesa nga Komuniteti Bektashi në Përmet përfaqësuar nga Sekretari i Teqeve, z.Fatjon Skënderi shoqëruar me listën e emerave që kanë nënshkruar për këtë propozim.
2. Biografia e shkurtër e Baba Hekuran Nikollarit.
3. Harta (*orthofoto*) e pozicionimit të rrugës që propozohet për emërtim.
4. Dokumentacion shoqërues mbi pastërtinë e figurës.

## HARTUESIT E RELACIONIT

Konceptoi

Administratori i Shëbimeve Publike: **Arian JAUPI**



Pranoi

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit: **Ing. Laert BUSHI**



**Ing. Paskal LONDO**



Drejtoresha e arësimit-kulturës dhe përfshirjes sociale: **Ariana PAPAPANO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KRYETARI

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_ dt. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

**PËR EMERTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË PËRMET.**

me emrin: **DHIMITËR LIÇI** (pas vdekjes)

Në mbështetje të Nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b" nënpika 1.7 shkronja "b" neni 54 shkronja II" dhe nenit 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, , veçanërisht dispozitat që përcaktojnë kompetencat e këshillit bashkiak për administrimin e çështjeve me interes vendor dhe emërtimin e hapësirave publike; neni 3 të ligjit 9270 datë 29.07.2004 "Për systemin e adresave" të ndryshuar, kërkesa e paraqitur nga një grup intelektualësh të qytetit Përmet mbi bazën e relacionit të paraqitur si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Përmet

**V E N D O S I**

1. Miratimin e emërtimit me emrin **DHIMITËR LIÇI** (pas vdekjes) të rrugës, Sipas fragmentit të hartës së paraqitur bashkëlidhur këtij Vendimi si më poshtë:  
*"Segmenti nga kryqëzimi i rrugës për në Këlcyrë deri tek kryqëzimi i rrugës së Çarçovës". Me kordinata sipas KRGJSH, pika e fillimit: E 530205.73 N 4455630.17, pika e mbarimit E 530457.17 N 4455617.15.*
2. Çdo Vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Ekonomise Zhvillimit Buqësisë e Turizmit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55 pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Alma HOXHA**

*Alma Hoxha*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

RELACION

PËR EMERTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË PËRMET.

me emrin "DHIMITËR LIÇI" (pas vdekjes)

**HYRJE**

Nisur nga kërkesa e paraqitur nga një grup intelektualësh të qytetit Përmet por jo vetëm, por edhe si një nderim dhe lartësim i modeleve më të mira qytetare dhe profesionale për një përfaqësim dinjitoz të një brezi të tërë njerëzish që hodhën themelet e transformimit ekonomik, kulturor, urbanistik në një epokë të re për qytetin tone hartohet ky relacion për emërtim rruge.

Në kuadër të ruajtjes dhe promovimit të vlerave historike, kulturore, shpirtërore dhe identitare të Bashkisë Përmet, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, historike, intelektuale dhe shoqërore të qytetit si dhe në funksion të përmirësimit të sistemit të adresave dhe identifikimit të hapësirave publike, paraqitet për shqyrtim dhe miratim propozimi për emërtimin e rrugës "*Segmenti nga kryqëzimi i rrugës përnjë Këlcyrë deri tek kryqëzimi i rrugës së Çarçovës*". me emrin "**Dhimitër Liçi**" (pas vdekjes)

Si nderim dhe lartësim i modeleve më të mira qytetare dhe profesionale por dhe për një përfaqësim dinjitoz të një brezi të tërë njerëzish që hodhën themelet e transformimit ekonomik, kulturor, urbanistik në një epokë të re për qytetin tonë.

Ky propozim synon nderimin e figurës së intelektualit, **Dhimitër Liçi** i cili me veprimtarinë e tij shumëvjeçare ka dhënë një kontribut të çmuar në jetën, shoqërore, ekonomike, dhe kulturore të qytetit të Përmetit dhe më gjerë.

**I. Baza e propozimit**

Në mbështetje Neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b" nënpika 1.7 shkronja "b" neni 54 shkronja II" dhe neni 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, , veçanërisht dispozitat që përcaktojnë kompetencat e këshillit bashkiak për administrimin e çështjeve me interes vendor dhe emërtimin e hapësirave publike; neni 3 të ligjit 9270 datë 29.07.2004 "Për systemin e adresave" të ndryshuar,  
Në mbështetje të legjislacionit në fuqi për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike, paraqitet propozimi për emërtimin e një rruge me emrin "Dhimitër Liçi", pas vdekjes, në nderim të kontributit të tij në jetën publike, institucionale dhe demokratike të vendit.

**II. Të dhëna biografike**

Dhimitër Liçi ishte një personalitet i njohur i jetës shoqërore dhe publike, i cili dha kontribut të rëndësishëm në periudhën e ndryshimeve demokratike në Shqipëri.

Ai kreu studimet e larta në Fakulteti Ekonomik i Tiranës, duke u formuar profesionalisht në fushën e ekonomisë.

Gjatë periudhës së ndryshimeve demokratike të viteve 1990–1991, ai mori pjesë aktivisht në proceset demokratizuese të vendit. Për shkak të integritetit, aftësive organizative dhe besimit që gëzonte në komunitet, u zgjodh dhe ushtroi detyrën e Kryetarit të parë të Këshillit të Rrethit, duke kontribuar në ngritjen dhe funksionimin e institucioneve vendore në periudhën e tranzicionit demokratik.

Veprimtaria e tij u karakterizua nga përkushtimi ndaj interesit publik, zhvillimit të komunitetit dhe forcimit të institucioneve demokratike.

### III. Vlerësimi i kontributit

Kontributi i Dhimitër Liçit përbën një vlerë të veçantë për historinë dhe kujtesën institucionale të komunitetit. Roli i tij në proceset demokratike dhe në administrimin vendor e bën atë një figurë të denjë për t'u përkujtuar dhe nderuar nga brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Emërtimi i një rruge me emrin e tij do të shërbejë si shprehje e mirënjohjes publike për veprën dhe kontributin e tij në shërbim të qytetarëve.

Propozimi për emërtimin e rrugës me emrin “Dhimitër Liçi” mbështetet në kontributin e tij të spikatur në jetën publike dhe institucionale, para viteve '90, si dhe në rolin e tij aktiv në proceset demokratike të vendit gjatë viteve 1990–1991.

Dhimitër Liçi ishte ndër qytetarët që u angazhuan në ndryshimet demokratike të asaj periudhe historike, duke kontribuar në forcimin e vlerave demokratike dhe në ndërtimin e institucioneve të reja të qeverisjes vendore. Besimi dhe vlerësimi që gëzonte në komunitet u konkretizuan me zgjedhjen e tij si Kryetari i parë i Këshillit të Rrethit, detyrë që e ushtroi me përgjegjësi dhe përkushtim në një periudhë të rëndësishme tranzicioni për vendin.

Formimi i tij akademik në Fakulteti Ekonomik i Tiranës dhe veprimtaria e tij publike dëshmojnë për përgatitjen profesionale dhe angazhimin e vazhdueshëm në shërbim të interesit qytetar.

Emërtimi i një rruge me emrin e tij përbën një akt vlerësimi dhe mirënjohjeje publike për kontributin e dhënë në zhvillimin e jetës demokratike dhe institucionale, si dhe një mënyrë për të ruajtur dhe përcjellë kujtesën historike të komunitetit tek brezat e ardhshëm. Përmes këtij emërtimi nderohet figura e një qytetari që me veprimtarinë dhe përkushtimin e tij ka lënë gjurmë të vlefshme në historinë dhe jetën publike të zonës.

### IV. Propozimi

Për sa më sipër, propozohet që rruga “Segmenti nga kryqëzimi i rrugës për në Këlcyrë deri tek kryqëzimi i rrugës së Çarçovës”, e ndodhur në territorin e qytetit të Permetit, të emërtohet: “RRUGA DHIMITËR LIÇI” në nderim dhe kujtim të veprimtarisë së tij qytetare, profesionale dhe institucionale.

### BASHKËLIDHUR:

1. Kërkesa nga një grup intelektualësh të qytetit por jo vetëm që kanë nënshkruar për këtë propozim.
2. Biografia e shkurtër e Dhimitër Liçit e paraqitur nga kërkuesit. (bashkëlidhur kërkesës)

3. Harta e pozicionimit të rrugës që propozohet për emërtim.
4. Dokumentacion shoqërues mbi pastërtinë e figurës.



### **HARTUESIT E RELACIONIT**

*Konceptoi*

*Administratori i Shëbimeve Publike: Arian JAUPI*

*Pranoi*

*Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit: Ing. Laert BUSHI*

*Ing. Paskal LONDO*

*Drejtoresha e arësim-kulturës dhe përfshirjes sociale: Ariana PAPAPANO*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KRYETARI

PROJEKT - VENDIM

Nr \_\_\_ datë: \_\_\_/\_\_\_/2026

PËR EMERTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË PËRMET.

me emrin: PEÇI NIÇKA (Dëshmori i Atdheut)

Në mbështetje të Nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b" nënpika 1.7 shkronja "b" neni 54 shkronja II" dhe nenit 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, , veçanërisht dispozitat që përcaktojnë kompetencat e këshillit bashkiak për administrimin e çështjeve me interes vendor dhe emërtimin e hapësirave publike; neni 3 të ligjit 9270 datë 29.07.2004 "Për systemin e adresave" të ndryshuar, Kërkesa nga Organizata e Familjeve të Dëshmorëve të Atdheut dega Përmet përfaqësuar nga Kryetari i Organizatës, z.Tomor Kotorri mbi bazën e relacionit të paraqitur si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Përmet

VENDOSI

1. Miratimin e emërtimit me emërin **PEÇI NIÇKA Dëshmori i Atdheut** të një segmenti rruge në Lagjen SMT me gjatësi 170 ml, Sipas fragmentit të hartës së paraqitur bashkëlidhur këtij Vendimi si më poshtë: *Me kordinata sipas KRGJSH, pika e fillimit: E 530347.34 N 4455255.34, pika e mbarimit E 530174.72 N 4455099.00. L=160 ml*
2. Ngarkohen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Ekonomise Zhvillimit Buqësisë e Turizmit për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55 pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar

KRYETARI I BASHKISË SHQIPËRISË  
Alma HOXHA

*Alma HOXHA*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

RELACION

**PËR EMERTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË PËRMET.**

**Lënda:** Propozim për emërtimin e një rruge në nderim të dëshmorit të atdheut **PEÇI NIÇKA**

Propozohet që një segmenti rruge në Lagjen SMT, në territorin e Bashkisë Permet, të emërtohet me emrin " **Peçi Niçka** ", dëshmor i atdheut, figurë e njohur e krahinës së Frshërit, i cili dha jetën në luftë për çlirimin e vendit. në vlerësim të figurës së tij, të ruajtjes dhe nderimit të vlerave historike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare,

**HYRJE**

Në kuadër të ruajtjes dhe promovimit të vlerave historike, kulturore, shpirtërore dhe identitare të Bashkisë Permet, si dhe në funksion të përmirësimit të sistemit të adresave dhe identifikimit të hapësirave publike, paraqitet për shqyrtim dhe miratim propozimi për emërtimin e njw segmenti rruge nw Lagjen Ish SMT me emrin "**Peçi Niçka**".

Ky propozim synon nderimin e figurës së dëshmorit të atdheut **Peçi Niçka**

**I. Baza Ligjore**

Ky propozim mbështetet në:

- Nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b" nënpika 1.7 shkronja "b" neni 54 shkronja II" dhe neni 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, , veçanërisht dispozitat që përcaktojnë kompetencat e këshillit bashkiak për administrimin e çështjeve me interes vendor dhe emërtimin e hapësirave publike;
- Legjislacionin në fuqi për sistemin e adresave dhe administrimin e territorit; neni 3 të ligjit 9270 datë 29.07.2004 "Për systemin e adresave" të ndryshuar
- Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak Permet;
- Ligji nr. 8607, datë 27.04.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", Në nderim të të rënëve në luftën për liri dhe pavarësi të Shqipërisë. *Neni 11 Në shenjë nderimi për Dëshmorët e Atdheut, me vendim të këshillit të qarkut ose të bashkisë ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen lapidare, pllaka përkujtimore, përmendore etj., si dhe emërtohen mjedise dhe institucione publike.*
- Nevojën për ruajtjen dhe promovimin e vlerave historike, kulturore dhe shpirtërore të territorit të Bashkisë Permet.

Në mbështetje të këtyre dispozitave, Këshilli Bashkiak ka të drejtën të vendosë emërtimin e rrugëve dhe hapësirave publike brenda territorit administrativ të Bashkisë Permet.

- Qëllimi i këtij propozimi është emërtimi i një segmenti rruge në Lagjen SMT me emrin dëshmorit të atdheut **Peçi Niçka** në shenjë respekti të përhershëm për veprën e tij.

### III. TË DHËNA MBI FIGURËN E Peçi Niçka

Peçi Niçka ishte nga Fsahti Miçan i krahinës së Frashërit. i lindur në vitin 1921 nga një familje me ndjenja të larta patriotike. Mbas kthimit nga Italia në moshën 20-vjecare në vitin 1942 lidhet me LANÇ që vepronin në zonën Kolonjë-Dangëlli. Ishte një ndër partizanët e parë të çetës së "Musa Fratari" Në Shtator të vitit 1943 bëhet efektiv i batalionit "Naim Frashëri" Ka marrë pjesë në luftën e tendes së qypit trup me trup me gjermanët. Gjithashtuka marrë pjesë në luftimet që janë zhvilluar në Zlesushë, Trenisht, Përmet, Mali i Bardhë, Kìçok, Dëshnicë etj. Më 22 Mars 1944 bie heroikisht në luftën e Malishtës.

### IV. ARSYETIMI I PROPOZIMIT

Emërtimi i rrugës me emrin "**Peçi Niçka**" mbështetet në disa arsye themelore:

#### 1. Nderimin e kujtimit dhe veprës së tij.

- Përjetësimin e kujtimit dhe të veprës së Dëshmorit Peçi Niçka në memorien historike të komunitetit. i njohur për guxim, shkathtësi luftarake dhe përkushtim të pashoq ndaj atdheut, ai dha kontribut të çmuar në përpjekjet për liri dhe për largimin përgjithmonë të okupatorit fashist,
- Nderimin dhe vlerësimin e sakrificës së tij për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut.
- Ruajtjen dhe transmetimin e vlerave patriotike që ai mishëroi me jetën dhe veprimtarinë e tij.
- Shprehjen e mirënjohjes së komunitetit ndaj kontributit dhe sakrificës së tij sublime.
- Edukimin e brezave të rinj me vlerat e lirisë, atdhedashurisë dhe sakrificës.

#### 2. Ruajtjen e trashëgimisë historike të komunitetit.

Ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë historike dhe patriotike të komunitetit.

Ruajtjen e kujtesës historike dhe të vlerave të trashëguara nga brezat që kontribuuan për lirinë e vendit.

Pasurimin e identitetit historik të komunitetit nëpërmjet përjetësimit të figurave të shquara vendore.

Përcjelljen te brezat e rinj të vlerave historike dhe atdhetare të komunitetit.

#### 3. Ruajtja e kujtesës historike lokale. Edukimin e brezave të rinj me vlerat e lirisë, atdhedashurisë dhe sakrificës

Bashkia Përmet ka detyrimin institucional të ruajë dhe promovojë figurat që kanë lënë gjurmë të rëndësishme në historinë dhe identitetin e saj historik. Emërtimi i një rruge me emrin e dëshmorit **Peçi Niçka** do të shërbejë si një formë e qëndrueshme kujtese për brezat e ardhshëm.

Ruajtja e kujtesës historike lokale, nëpërmjet përjetësimit të figurës dhe veprës së Dëshmorëve të atdheut, si pjesë e trashëgimisë historike dhe vlerave atdhetare të komunitetit.

#### 4. Kërkesë me interes publik

Emërtimi i propozuar gëzon interes publik pasi lidhet me një figurë të njohur dhe të respektuar nga komuniteti lokal, si dëshmor i atdheut duke mos krijuar mbivendosje apo konfuzion me emërtime të tjera ekzistuese në territorin e bashkisë.



Duke marrë në konsideratë:

- respektin dhe vlerësimin e dëshmorëve të atdheut në komunitetin përmetar;
- rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë historike dhe identitare të Bashkisë Përmet;

vlerësohet se ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore, historike dhe morale për emërtimin e rrugës së propozuar me emrin: **“PEÇI NIÇKA”**

## VI. Konkluzioni

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak Përmet të miratojë emërtimin e një segmenti rruge në lagjen SMT me emrin:

### “RRUGA PEÇI NIÇKA”

si shenjë nderimi dhe mirënjohjeje që synon përjetësimin e kujtimit dhe të veprës së tij, si dhe shprehjen e mirënjohjes së komunitetit për sakrificën e dhënë në luftën për çlirimin e vendit.

## BASHKËLIDHUR:

1. Kërkesa nga Organizata e Familjeve të Dëshmorëve të Atdheut dega Përmet përfaqësuar nga Kryetari i Organizatës, z.Tomor Kotorri që kanë nënshkruar këtë propozim.
2. Biografia e dëshmorit të atdheut **Peçi Niçka**. (nga kerkuesi Shoqata e dëshmorëve)
3. Harta e pozicionimit të rrugës që propozohet për emërtim.
4. Dokumentacion shoqërues mbi pastërtinë e figurës.

## HARTUESIT E RELACIONIT

*Konceptoi*

Administratori i Shëbimeve Publike: **Arian JAUPI**

*Pranoi*

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit: **Ing. Laert BUSHI**

**Ing. Paskal LONDO**

Drejtoresha e arësim-kulturës dhe përfshirjes sociale: **Ariana PAPAPANO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**P/VENDIM**

**Për vënien e emrit Et”hem Kaso ”Pallatit të Sportit Përmet**

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54 pika II ,Neni 55 e në vijim, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,Vendimi Nr.33 datë 22.01.2026 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, Ligji Nr.94/2022 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë,nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Bashkiak me propozim të Shoqatës “Dëshnica ”

**VENDOSI**

**1 – T”i vërë emrin “Et”hem Kaso ” Pallatit të Sportit Përmet**

*me motivacionin :*

*Në shenjë nderimi dhe mirënjohje për kontributin e tij të shquar në arsim,edukimin e brezave të rinj dhe zhvillimin e sportit në komunitetin përmetar.*

*2- Ky vendim shpallet brenda 10 ditëve nga data e miratimit.*

**KRYETARI**  
**Alma HOXHA**



Sheshi “Abdyl Frashëri”;tel.+35581322254;.bashkiapermet.gov.al;e-mail:info@bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET



Përmet më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

RELACION

**Drejtuar :** Këshillit Bashkiak

**Lënda :** Propozim për vënien e emrit "Et"hem Kaso" Pallatit të Sportit Përmet

Me propozim të Shoqatës " Dëshnica " është paraqitur para Jush dokumentacioni dhe relacioni përkatës për vënien e emrit " Et"hem Kaso " pallatit të sportit.

Po japim më poshtë një përshkrim të shkurtër për jetën dhe veprën e z. Et"hem Kaso.

Et"hem Kaso është një personalitet i shquar nga Përmeti, i njohur si themeluesi i traditës 65-vjeçare të basketbollit në këtë qytet dhe trajner legjendar i ekipit të femrave. Për kontributin e tij të vyer në edukimin fizik dhe stërvitjen e brezave, ai është vlerësuar me titullin e lartë "Mjeshtër i Madh". dhe "Qytetar Nderi".

Ka lindur në Përmet, në 15 Janar 1941 qytet ku konsiderohet si një nga simbolet më të dashura të sportit lokal.

Mësues i edukimit fizik dhe trajner i palodhur i vajzave. Ai është vlerësuar si një nga 10 personalitetet e qytetit dhe është nderuar publikisht nga bashkësia për karrierën e tij.

Njihet si "Guri i dytë" i Përmetit, pasi puna e tij e nisi basketbollin në këtë qytet dhe e ngriti atë në nivele kombëtare.

Një nga krenaritë lokale me të cilat mburret Përmeti ynë është dhe mbetet basketbolli. Në fillim të viteve '60 profesori i nderuar Et'hem Kaso ngriti ekipet e para të meshkujve për femra e meshkujve në qytet. Mes paragjytimeve të shumta, profesori dhe lojtarët amatorë vazhduan duke mos e tjetërsuar misionin e tyre. Ndër vite ekipi i femrave u konsolidua duke e vazhduar traditën edhe sot pas shumë vitesh. Dhjetra e qindra basketbolliste përmetare i shtuan sportit shqiptar vlerat dhe kontributet. Puna e palodhur e trajnerit të apasionuar të basketbollit Et'hem Kaso u shpërblye me shpalljen e ekipit të rejave tona Kampione për vitin 2014.

Profesor Et'hem Kaso ka marrë titullin " Mjeshtër i Madh "për kontributin e punën e përbashkët në ekip,të të gjitha institucioneve sportive të Përmetit të cilat kanë dhënë kontributin e tyre dhe kanë bashkëpunuar duke bërë të mundur që sporti i basketbollit për femra në përmet të arrijë rezultate mjaft të respektuara të niveleve kombëtare.

Gjatë karrierës së tij profesori ka dëshmuar profesionalizëm të lartë,integritet dhe përkushtim të vazhdueshëm në zhvillimin e sportit duke ndikuar pozitivisht në edukimin dhe sukseset e nxënësve duke lënë gjurmë të rëndësishme në komunitet që shërbejnë si model frymëzimi për breza të tërë sportistësh dhe edukatorësh.

Një nga karakteristikat me të cilat mburret Përmeti ynë dhe një tjetër arsye pse Përmeti është shkruar në librin e emancipimit civil shqiptar mbetet basketbolli i femrave.



Ndër vite ekipi i femrave u konsolidua duke e vazhduar traditën edhe sot pas kaq vitesh tek vajzat e reja përmetare. Ky sport ndiqet masivisht sidomos nga nxënës të shkollave të mesme por edhe fillore.

Alternativë për tu argëtuar por dhe një mundësi për një shëndet më të mirë, ky sport është shprehur ndër më të dashurit në qytet.

S'ka mbasdite apo fundjavë që Pallati i Sportit nuk gumëzhin nga zërat e fëmijëve dhe driblimet e topit të basketbollit. Kontribut të veçantë për këtë traditë ka pa diskutim profesori i nderuar Et'hem Kaso.

Emërtimi i këtij institucioni sportive me emrin e tij do të shërbejë si një vlerësim i

merituar për kontributin e dhënë në vite si dhe një burim frymëzimi për brezat e ardhshëm që do të ushtrojnë sport dhe do të ndjekin vlerat e punës, përkushtimit dhe integritetit që ai përfaqësoi.

Në këtë mënyrë kujtimi dhe trashëgimia e profesor Et'hem Kaso do mbeten të gjalla në jetën sportive dhe qytetare të Përmetit.

Për këto merita të veçanta si shenjë mirënjohje dhe respekti për veprën dhe kontributin e tij të çmuar e kemi për nder që pallatit të sportit t'i vendoset emri nderuar i profesor Et'hem Kaso, ikona e basketbollit përmetar.

Bashëngjitur gjithë dokumentacioni përkatës

Drejtori Shërbimit Social  
Arjana PAPAPANO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2026

**P/VENDIM**

**Për dhënie titulli “ Qytetar Nderi i Përmetit”**

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54 pika m, Neni 55 e në vijim, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Vendimi Nr.33 datë 22.01.2026 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, Ligji Nr.94/2022 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë, nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Bashkiak me propozim të Shoqatës “Dëshnica ”

**VENDOSI**

1 – T’i japë titullin “Qytetar Nderi i Përmetit”

**Z. Et’hem Bejo.**

me motivacionin :

*“ Me vlerësim të lartë për kontribut të jashtëzakonshëm dhe shumëvjeçar në fushën e edukimit fizik dhe sportit, për përkushtimin e palodhur në formimin e brezave të rinj si dhe për rolin e tij të rëndësishëm në promovimin e vlerave sportive, edukative dhe qytetare duke shërbyer si model frymëzimi për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.*

2- Ky vendim shpallet brenda 10 ditëve nga data e miratimit.

**KRYETARI**  
**Alma HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Përmet më \_\_. \_\_. 2026

RELACION

Drejtuar : Këshillit Bashkiak  
Lënda : Propozim për dhënie titulli "Qytetar Nderi "

Me propozim të Shoqatës " Dëshnica " është paraqitur para Jush dokumentacioni dhe relacioni përkatës për dhënie titulli "Qytetar Nderi"i Përmetit për z.Et'hem Bejo.

Po japim më poshtë një përshkrim të shkurtër për jetën dhe veprën e z. Et'hem Bejo.

Profesor Et'hem Bejo ka lindur në 18 janar 1941.Ai është një nga figurat më të respektuara dhe të dashura të arsimit dhe sportit në qytetin e Përmetit. I njohur si legjendë e gjimnastikës dhe pingpongut, ai ka ndërtuar një karrierë të gjatë dhe pasionante në edukimin fizik, duke formuar ndër breza talente të shumta sportive.

Profesor Et'hem Bejo është një figurë e njohur dhe personalitet i shquar i sportit dhe arsimit në Përmet, i njohur gjerësisht si "legjenda e gjimnastikës dhe pingpongut përmetar".

Ai ka trajnuar dhe udhëhequr ndër vite breza të të rinjve, vajzave dhe djemve, duke i sjellë qytetit të Përmetit tituj kampionë në volejboll, basketboll (me vajzat) dhe ping-pong.

Si një njohës i thellë i historisë lokale, ai është autor i librit "Sporti në Përmet "(botuar në vitin 2004), i cili dokumenton zhvillimin e aktiviteteve fizike dhe futbollit në qytet që prej vitit 1916.

Në qytetin tonë sporti i pingpongut është zhvilluar dhe vazhdon të zhvillohet falë punës të profesor Et'hem Bejo , i cili ka krijuar një ekip djemsh të talentuar që stërviten rregullisht dhe shpesh herë kanë rrëmbyer edhe kupat e fitores

Prof. Bejo vijon të jetë i angazhuar me të rinjtë në qytetin tonë duke përgatitur kampionë të rinj në Kampionatin Kombëtar të Pingpongut U11 & U17 .

Ka shërbyer si ish-shef i sporteve në Komitetin Ekzekutiv të Përmetit dhe si trajner i palodhur i ekipeve të volejbollit, gjimnastikës dhe pingpongut. Ai është konsideruar gjerësisht si njeriu që ka mbajtur gjallë dhe ka zhvilluar këto disiplina në qytetin e Përmetit.

Me dekada përkushtim, ai ka formuar breza të tërë sportistësh,vajza dhe djem të talentuar që kanë sjellë kupa, rezultate dhe krenari për Përmetin.

Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në arsimimin dhe edukimin e të rinjve, Bashkia e Përmetit dhe Fondacioni "Niko Gjika" e kanë vlerësuar me çmime prestigjioze si "Mësuesi Ynë".

Gjatë karrierës së tij profesori ka dëshmuar profesionalizëm të lartë,integritet dhe përkushtim të vazhdueshëm në zhvillimin e sportit duke ndikuar pozitivisht në edukimin dhe sukseset e nxënësve duke lënë gjurmë të rëndësishme në komunitet që shërbejnë si model frymëzimi për breza të tërë sportistësh dhe edukatorësh.

Për këto merita të veçanta si shenjë mirënjohje dhe respekti për veprën dhe kontributin e tit të çmuar e kemi për nder që profesor Et'hem Bejos ti jepet titulli "Qytetar Nderi i Përmetit".

Në Janar 2026, Prof. Et'hem Bejo festoi 85-vjetorin e lindjes, duke marrë urime të shumta nga komuniteti përmetar dhe nxënësit e tij që e njohin përkushtimin e tij të palëkundur ndaj sportit

Bashëngjitur gjithë dokumentacioni përkatës

Drejtori Shërbimit Social  
Arjana PAPAPANO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Përmet më \_\_\_\_\_.2026

**P/VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI QERSHOR 2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,date 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për percaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2026 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

**VENDOSI**

1.Të përfitojne ndihme ekonomike për Muajin QERSHOR 2026, 34 familje me një fond **127.100 lekë.**

2.Fondet të përballohen nga struktura :

**1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.05.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 127.100 lekë**

3. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma/leke
1	Ziso Apostol Kristo	Valentina Polikron Kristo	3	4200
2	Xhilda Xhemal Selimllari	Xhilda Xhemal Selimllari	2	3600
3	Mitro Gani Zeqiri	Lefteri Rrapi Zeqiri	4	4700
4	Syrja Mehmet Hoxha	Beqar	1	3200
5	Drita Irakli Kosta	Divorcuar	2	3600
6	Lefteri Polikron Proko	E ve	1	3200
7	Andon Dhimitraq Kukureci	I ve	2	3600
8	Aferdita Nuredin Lahe	Beqare	1	3200
9	Arben Thoma Teka	Mirela Xheli Teka	6	5400
10	Viktor Josif Proko	Divorcuar	1	3200
11	Dhimo Naun Dimçi	Lindita Hysen Dimçi	3	4200
12	Vera Thanas Nage	E ve	2	3600

13	Leonart Petro Markaj	Kristina Petraq Markaj	3	4200
14	Thoma Aristidh Ilia	Maria Nuredin Ilia	4	4700
15	Xhensila Maksim Jahjaj	Beqare me Femijë	2	3600
16	Violeta Guce Pelushi	Beqare	1	3200
17	Engjellushe Manxho Canollari	E ve	1	3200
18	Rivelino Fatmir Doko	Hurma Leonidha Doko	4	4700
19	Bajame Fari Hysenshahaj	E ve	1	3200
20	Lida Koco Thomollari	Divorcuar	1	3200
21	Vasilika Bedri Malka	E ve	2	3600
22	Ilir Sali Jashari	Beqar	1	3200
23	Vitori Llazo Caci	Beqare	2	3600
24	Luam Ferit Zeneli	Gezime Tafil Zeneli	4	4700
25	Ilber Kudret Dalipaj	Divorcuar	1	3200
26	Kastriot Kristo Koto	Kastriot Kristo Koto	3	4200
27	Kastriot Astrit Male	Divorcuar	1	3200
28	Vangjush Thanas Mamillo	Gentiana Seit Mamillo	3	4200
29	Bari Avni Zaimi	Valbona Zenel Zaimi	2	3600
30	Kadri Petrit Maska	Beqar	1	3200
31	Dashnor Guçe Pelushaj	Vezire Ali Pelushaj	4	4700
32	Klodiana Kristofor Peçi	Divorcuar	1	3200
33	Lulëzim Barjam Beqari	Divorcuar	1	3200
34	Ylli Guçe Pelushaj	Zylkade Qerim Pelushaj	2	3600
	<b>SHUMA</b>			<b>127.100</b>

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Sektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6,të nenit 55,të ligjit nr.139/2015,"Për vetqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

**KRYETAR I BASHKISË**  
Alma HOXHANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Përmet më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2026

RELACION

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI QERSHOR 2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë.20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe shërbimet shoqerore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr.617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punojësve të bashkisë, institucioneve në varësi të saj.Familje të cilat janë përfituese në fondin e bashkisë janë ato familje të cilat mbasi kanë bërë aplikimin në Sistemin e Ndihmës ekonomike, rekomandimin në fondin 6% nuk janë fituese. Dhe nga vizitat e kryera në familje nga Administratorët shoqëror duke parë gjëndjen ekonomike të këtyre familjeve të cilat janë në gjëndje të dobët ekonomike u arsyetua që të përfshihen në fondin e familjeve në nevojë.

**Përsa më sipër rekomandojmë të ndihmohen për muajin Qershor 34 familje me një vlerë prej 127.100 lekë.**

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Përmet më \_\_\_\_\_, 2026

**P/VENDIM**

**Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmës ekonomike, deri në 6% .**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmen dhe shërbimet shoqerore " i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 "Për disa ndryshime në Vendimin 597 dt.04.09.2019 të K.M."Për percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të perfitimit të ndihmës ekonomike dhe perdorimit të fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmën ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perditësuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026 dhe percaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi të saj". Keshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë:

**VENDOSI**

1.Të përfitojnë ndihmë ekonomike për Muajn Maj 2026, 5 familje me një fond prej 17.481 lekë.

2. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atësia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma
1	Roland Petraq Jorgji	Divorcuar	1	2.178
2	Lame Enver Ferati	Silvana Kujtim Ferati	3	5.227
3	Mimoza Skënder Gjoka	Divorcuar	1	2.178
4	Lefteri Mihal Tyto	Divorcuar	1	5.720
5	Flavia Musa Pelushaj	Beqare	1	2.178
	<b>SHUMA</b>			<b>17.481</b>

3..Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmës ekonomike.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetqeverisjen Vendore", (i ndryshuar).

**KRYETAR I BASHKISË**  
**Alma HOXHA**

*Alma Hoxha*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Përmet më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

RELACION

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËS  
EKONOMIKE, DERI NË 6% .**

Mbështetur në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”Ligjit 935datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”I ndryshuar me VKM Nr.955 datë 07.12.2016(kreu II pika 13)dhe udhëzimi nr.5 datë 17.02.2017 pika 2 i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.Për përcaktimin kriterëve,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe VKM nr.85 dat10.02.2021,nr.868,datë 29.12.2021;n.617,datë 22.09.2022 i përditësuar Vendimi i,Këshillit Bashkiak Përmet me fonde të Buxhetit Vendor Nr.113 datë 17.12.2025”Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë,institucioneve në varësi të saj “Këshilli Bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,deri 6% të bllok ndihmës ekonomike të muajit.Maj 2026 me Vendim të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Socail Gjirokastër.Nr.10/2022 datë 27/10/2022 për dhënien e NE për periudhën 01-31-2026 Për Bashkinë Përmet.(Sipas vendimit të Muajit Maj 2026).

Për sa më sipër vlera e fondit të kushtëzuar (bllok ndihma ekonomike) për Muajin Maj 2026

është 44 familje me,Shumën prej 324.056 lekë dhe për tu trajtuar familje me ndihmë ekonomike janë në dispozicion 6% e këtij fondi ose 19.443 lekë,për Muajin Maj 2026.

Mbështetur në të dhënat për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-31 Maj 2026 kanë aplikuar 5 familje asedhenjë familje nuk ka dalë fituese 44 janë përfituese në skemën e Ndhmës Ekonomike.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikuesve që nuk kane marë pikët e mjaftueshme për periudhën 01 Maj deri më datën 31 nga vlersimi i SH.S.SH rekomandojmë:

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar prej 6%,5 familje me një vlerë 17.481 lekë,nga ku fondi 6% në total sipas vendimit është në Shumën 19.443 lekë diferenca prej 1.962 lekë do të mbetet e papërdorur për muajin Maj .

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI



Sheshi “Abdyl Frashëri”;tel.+35581322254;

e-mail: info@bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2026

Për

## MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore " ,Ligjin Nr. 68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore ",Ligjin 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë "i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar , Ligji Nr.87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", Vendimi i KB Nr.113 datë 17.12.2025 "Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026" dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj" ,Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

### V E N D O S I

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara ( për dhënie ndihme financiare ) në masën 80.000 ( tetëdhjetë mijë ) lekë. për sa më poshtë vijon:

- |    |               |                                  |                               |
|----|---------------|----------------------------------|-------------------------------|
| 1  | Astrit Aliu   | të përfitojë përkatësisht shumën | 20.000 ( njëzetë mijë ) lekë. |
| 2. | Aleks Xhoga   | të përfitojë përkatësisht shumën | 20.000 ( njëzetë mijë ) lekë. |
| 3. | Xhafer Lilo   | të përfitojë përkatësisht shumën | 20.000 ( njëzetëmijë ) lekë   |
| 4. | Marjana Stefo | të përfitojë përkatësisht shumën | 20.000 ( njëzetëmijë ) lekë   |

- 2 Miratimin e transferimit buxhetor si më poshtë :

Pakësim në strukturën buxhetore :



GR 00,TIT AF135,KAP 05,ART 609,Kod Produkti V494AAA në shumën 80.000 lekë

Shtesa në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 05,ART 606,Kod Produkti V494AAA në shumën 80.000 lekë

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Financës dhe Tatim –Taksa/Sektori i Buxhet Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ( dhjetë ) ditë pas shpalljes.

## KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Përmet, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2026



RELACION  
DREJTUAR  
KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Pranë bashkisë është paraqitur kërkesë me Nr.1988 Prot datë 05.06.2026 nga shtetësi Astrit Aliu banues në Kosinë, Përmet i cili kërkon të ndimohet financiarisht nga bashkia pasi ka kryer ndërhyrje kirurgjikale, dhe kurimi për terapinë e tij është i kushtueshëm dhe nuk ka të ardhura të mjaftueshme për blerjen e ilaçeve.

Shtetësi Xhaferr Lilo ,banues në Përmet ka bërë kërkesë Nr.2026 Prot datë 10.06.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është në kushte shumë të vështira ekonomike, jetojnë së bashku me bashkëshorten me pensione të ulëta dhe nuk i mjaftojnë të ardhurat për blerjen e ilaçeve pasi janë të sëmurë që të dy.

Edhe shtetasi Aleks Xhoga banues në fshatin Iliarë ,Njësia Administrative Çarçovë ka bërë kërkesë me Nr.2143 Prot datë 22.06.2026 pranë bashkisë Përmet për t'u ndihmuar financiarisht pasi është në kushte shumë të vështira ekonomike, me nënën e sëmurë, vetë i sëmurë me P.A.K dhe nuk ka mundësi financiare për të marrë ilaçet.

Shtetësja Marjana Stefo banuese në Njësinë Administrative Çarçovë ka bërë kërkesë me Nr.2144 Prot datë 19.06.2026 pranë bashkisë Përmet për t'u ndihmuar financiarisht pasi është në kushte shumë të vështira ekonomike, burrin e kam të paralizuar, vajzën studente dhe nuk i mjaftojnë të ardhurat për të përballuar shpenzimet mujore.

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” ,Ligjin Nr. 68 /2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore ”, Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar, Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligji Nr.87/2025 “Për Buxhetin e vitit 2026”., VKB Nr.113 datë 17.12.2025 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj, kërkojmë që :

- |                |                                    |                               |
|----------------|------------------------------------|-------------------------------|
| 1- Astrit Aliu | të ndimohet përkatësisht në shumën | 20.000 ( njëzetë mijë ) lekë. |
| 2- Aleks Xhoga | të ndimohet përkatësisht në shumën | 20.000 ( njëzetë mijë ) lekë. |
| 3- Xhafer Lilo | të ndimohet përkatësisht në shumën | 20.000 ( njëzetë mijë ) lekë  |



4- Marjana Stefo të ndimohet përkatësisht në shumën 20.000 ( njëzetë mijë) lekë

Bashkëngjitur i gjithë dokumentacioni përkatës.

Drejtori Shërbimit Social

Arjana PAPAPANO